

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



DEPUTETI SHQIPTAR NË HAMBURG TAKIM ME DESTANIN: LOBIM PËR DIASPORËN SHQIPTARE

Deputeti i Partisë Socialdemokrate (SPD) gjermane, me origjinë nga Pozharani i Vitisë në Kosovë dhe aktualisht deputeti i parë me origjinë shqiptare në Parlamentin e Hamburgut, Z. Sami Musa, ka vizituar filantropin e mirënjohur shqiptar Z. Lazim Destani në Tetovë. Z. Destani është Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe President Nderi i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare. Takimi u realizua në një nga hapësirat e bizneseve të familjes Destani, në 'Ecolog International', e cila shquhet për konceptet vizionare biznesore dhe tashmë operon në më shumë se 40 vende të botës.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



FITCH SOLUTIONS PËRMIRËSON PARASHIKIMIN PËR RITJEN EKONOMIKE TË SHQIPËRISË

Fitch Solutions, një njësi e inteligjencës së agjencisë ndërkombëtare të vlerësimit Fitch, njoftoi se ka rishikuar në rritje me 1.5 pikë përqindje parashikimin për rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë për vitin 2021, duke e çuar atë në 5.7%. Ky vlerësim, i publikuar në raportin e fundit të riskut të Shqipërisë për 6 mujorin e dytë 2021 është në linjë të kundërt me atë të shkurtit të po këtij viti, ku 4.8% që ishte parashikimi i mëparshëm, pritej që ekonomia e vendit këtë vit të zgjerohej me 4.3%. Fitch Solutions parashikon që eksportet e mallrave do të rriten gjatë vitit ndërsa kërkesa nga Evropa përmirësohet, megjithëse eksportet e shërbimeve do të duan më shumë për t'u rikuperuar si rrjedhojë e ndërprerjeve të vazhdueshme nga Covid-19.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



AMNISTI PËR EMIGRANTËT E PALIGJSHËM, SHQYRTOHET KËRKESA E SHQIPTARËVE

Parlamenti britanik ka nisur shqyrtimin e një kërkesë, të komunitetit shqiptar atje, për një amnisti lidhur me legalizimin e emigrantëve të paligjshëm që qëndrojnë në Britaninë e Madhe. Kreu i Dhomës Britanike të Tregtisë dhe Industrisë, Zenel Hoxha në një intervistë për RTSH-në, tha se mund të përfitojnë më shumë se 50 mijë qytetarë shqiptarë, që ende nuk janë pajisur me dokumente. Në Britaninë e Madhe ka pasur 2 amnisti të mëparshme për emigrantët e paligjshëm, periudhë që përkon me kohën kur në krye të qeverisë ishte Tony Bler.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME

MEDIAT ÇEKE: SHQIPËRIA MUNDËSI TË PAFUNDME PËR TURIZËM



NJOHJA E PATENTAVE, AMBASADA ITALIANE KA NJË NJOFTIM TË RËNDËSISHËM



PUBLIKOHET NUMRI I DYTË I REVISTËS LETRARE "LETRA NGA DIASPORA", ONLINE FALAS



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.6	105.2
EUR	122.9	123.5
CHF	110.8	111.6
GBP	143.4	144.4
DKK	16 ^{.22}	16.62